



Datë: 28.04.2026

A.nr. 227/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.227/2026, të datës 02.03.2026, të parashtruar nga ankuesi A.M, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike *“kompensim material”* duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.227/2026, e datës 02.03.2026, e parashtruar nga ankuesja.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, A.M (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja), me datë 02.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative të Drejtorit të Përgjithshëm të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, lidhur me kërkesën e saj të datës 30.01.2026, për kompensimin e pagesës retroaktive për muajin shtator si dhe njohjes të së drejtës për 20% të shtesës funksionale për kryerjen e detyrave të certifikuesit/aprovuesit si funksion shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.03.2026 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek KKTK, ndërsa Këshilli më datë 17.03.2026 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 14.04.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:1947/2026, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjën A.nr.227/2026 të datës 02.03.2026 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje në këtë lëndë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1073/2026 të datës 02.03.2026, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kërkesën e ankueses të datës 30.01.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.03.2026; Përgjigje në kërkesë e datës 17.03.2026; Akt Emërimit e ankueses të datës 01.09.2021; Vendimin VK/2026 të Kryetarit të Këshillit i datës 14.04.2026.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses, **është e parakohshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër AE.nr.03/2021, të datës 01.09.2021, është punësuar në pozitën Zyrtare Administrative në kuadër të Zyrës së Udhëheqësit Ekzekutiv, në kuadër të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Ankuesja më datë 30.01.2026, i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për kompensimin e pagesës retroaktive për muajin shtator si dhe njohjes të së drejtës për 20% të shtesës funksionale për kryerjen e detyrave të certifikuesit/aprovuesit si funksion shtesë, ndërsa nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se ankuesja nuk ka marr përgjigje dhe me datë 02.03.2026 ka parashtruar ankesë në Këshill kundër heshtjes administrative të organit të punësimit në kërkesën e saj.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se organi i punësimit, respektivisht udhëheqësi më i lartë ia ka cenuar të drejtat në kompensim material dhe pagë, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e saj dhe të detyroj organin e punësimit të t'ia kryej dhe njoh kompensimet e kërkuara si në kërkesën e saj të datës 30.01.2026 për kompensimin e pagesës retroaktive për muajin shtator si dhe njohjes të së drejtës për 20% të shtesës funksionale.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: "1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: "1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.* 4. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...*" e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankueses e*

parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 02.03.2026 është e parakohshme, pasi që ankuesja ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 30.01.2026 dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri ligjor/kohor lidhur me heshtjen administrative parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji vlerëson se ankesa e ankueses është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që ankuesja kundër heshtjes administrative në kërkesën e saj të datës 30.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshill pa kaluar ende afati prej 45 ditësh si dhe parakushti tjetër ligjore që ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ, siç përcaktohet me nenin 98 paragrafin 2 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të LPPA-së.

Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës A.nr.227/2026, nuk nënkupton mohimin e së drejtës së ankueses që e njëjta sërish mund të ushtroj ankesë në pajtim me afatet e përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, nga ajo qw u tha si mw lartw dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.227/2026, datë 28/04/2026.

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.M;
- Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.